



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1486/3 Prot

Tiranë, më 25.10.2019

V E N D I M

Nr.99, datë 25.10.2019

“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të ankesës së nëpunëses civile ** , për masën disiplinore “largim nga shërbimi civil”, dhënë ndaj saj me aktin nr. 5656/9 prot., datë 03.09.2019, të Komisionit të Disiplinës së AKU.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të dokumentacionit që shoqëron vendimin nr. 5656/9 prot., datë 03.09.2019, të Komisionit të Disiplinës së AKU, për dhënien e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil” të inspektores së ushqimit ***** dhe pas kryerjes së hetimit të plotë administrativ të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të rregjistruar me nr. 1486 prot., datë 01.10.2019, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpunësja ***** ka parashtruar pretendimin se, ndaj saj është marrë në mënyrë të padrejtë dhe në zbatim të gabuar të legjislacionit material, masa disiplinore “largim nga shërbimi civil”.

Duke marrë indicje nga kjo kërkesë, bazuar në nenin 16, Kreut III, “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedura e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet akt-konstatimit të dt. 17.10.2019 të mbajtur në ambientet e AKU, u administrua gjithë dokumentacioni që materializon procedurën e ndjekur në dhënien e masës disiplinore.

Në përfundim të shqyrtimit të materialeve të administruara në kuadër të këtij hetimi administrativ, rezulton se nëpunësja ***** është nëpunëse civile, me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Jo-

shtazore dhe Operatorëve të Biznesit, në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë.

Në kuadër të kryerjes së detyrave funksionale, me autorizimin nr. AKU-TR-2019-004774-5, datë 27.06.2019, të Drejtorit Rajonal të AKU, Qarku Tiranë, është ngritur trupa inspektuese, me përbërje inspektorët ***** dhe ******, me objekt inspektimin e subjektit “*GUAIIACCHINO RAIA*”. Ky inspektim është iniciuar prej një denoncimi të paraqitur nga banorët e pallatit, ku ky subjekt ka selinë dhe ushtron aktivitetin e tij.

Në përfundim të inspektimit, nëpërmjet “*memos*” së datës 27.06.2019, trupa e mësipërme inspektuese ka informuar Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë, në lidhje me situatën e konstatuar pranë subjektit të inspektuar, si dhe marrjen ndaj tij të masës administrative “*Paralajmërim*”, e bazuar kjo në nenin 48, pika 1, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011, “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Duke krijuar përshtypjen se grupi i inspektimit në këtë rast kishte mbajtur qëndrim favorizues për subjektin e denoncuar, Drejtori i DRAKU Tiranë, nëpërmjet një autorizimi tjetër me nr. AKU-TR-2019-004910-1, datë 01.08.2019, ka ngritur një trupë tjetër inspektuese, më përbërje inspektorët ***** dhe ******, me qëllim “*Ri-inspektim në raste detyrash të lëna gjatë inspektimit*”, po në të njëjtin subjekt “*GUAIIACCHINO RAIA*”.

Trupa e dytë inspektuese, pasi ka përsëritur kontrollin në subjekt, ka arritur në konkluzionin se nga ana e subjektit të inspektuar nuk janë respektuar kërkesat ligjore në lidhje me a) pajisjen me licencë të subjektit për fushën e veprimtarisë që operon, b) kërkesat e përgjithshme të etiketimit të ushqimit dhe c) kërkesat ligjore për sistemin e vetëkontrollit të pajisjeve në përdorim.

Për këto arsye, kjo trupë inspektuese ka konkluduar në dhënien e dënimit administrativ si më poshtë:

- *Gjobë në masën 2.000.000 lekë për shkelje të kërkesave të nenit 19, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2009, “Për ushqimin”, i ndryshuar;*
- *Gjobë në masën 100.000 lekë për shkelje të kërkesave të nenit 36, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar;*
- *Gjobë në masën 100.000 lekë për shkelje të kërkesave të nenit 26, [pika 1, 2 dhe 4, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar.*

Kur ka konstatuar këto dy qëndrime të ndryshme, Drejtori i Përgjithshëm i AKU, nëpërmjet komunikimit elektronik (*e-mail* i datës 08.08.2019), ka kërkuar prej Auditit të Brendshëm verifikimin e ligjshmërisë së këtyre inspektimeve të kryera nga të dy trupat inspektuese, ndaj të njëjtit subjekt “*GUAIIACCHINO RAIA*”.

Në përfundim, Auditit i Brendshëm i AKU, ka arritur në konkluzionin se inspektimi i kryer nga inspektorët ***** dhe ******, është kryer në shkelje të akteve ligjore, duke cenuar sigurinë ushqimore me mosveprimet e tyre, duke shkelur në këtë mënyrë kërkesat e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, i

ndryshuar, kërkesat e nenit 42 dhe 43, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9863, datë 28.01.2009, “Për ushqimin”, i ndryshuar.

Me marrjen dijëni të shkeljeve të evidentuara në raportin përfundimtar të Auditit të Brendshëm, Drejtori i DRAKU Tiranë, në cilësinë e eprorit direkt, me aktin nr. 3139/2 prot., datë 14.09.2019, (*sqarojmë se data është lapsus, pasi konkretisht akti është nxjerrë në datën 14.08.2019*), ka kërkuar fillimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses *****.

Meqënëse shkeljet e konstatuara janë klasifikuar si mospërbushje të rëndë të detyrave dhe moszbatim të dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale, eprori direkt në zbatim të nenit 57, pika 2, germa a) dhe c), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka vendosur kalimin e akteve për shqyrtim Komisionit Disiplinor. Në vijim, me urdhrin nr. 5656/1 prot., datë 21.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, është ngritur Komisioni Disiplinor me përbërje të rregullt, si më poshtë:

- ***** , Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU – kryetar, me cilësinë e nëpunësit civil më të lartë në institucion;
- ***** , Drejtor në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë (*komanduar në këtë pozicion me aktin nr. 2723 prot., datë 08.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU*) - anëtar, me cilësinë e eprorit direkt;
- ***** , Përgjegjëse në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Trajnimit dhe Shërbimeve – anëtar, me cilësinë e përfaqësuesit të njësisë së burimeve njerëzore;
- ***** , Inspektor në Sektorin e Koordinimit dhe Mbështetjes së Laboratorëve, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU – anëtar, në cilësinë e nëpunësit më të vjetër të institucionit;
- ***** – anëtar, me cilësinë e përfaqësuesit të DAP (*caktuar me autorizimin nr. 5018 prot., datë 28.08.2019*).

Komisioni Disiplinor, mbi bazën e gjithë sa u thanë më sipër, ka nisur ecurinë disiplinore për thyerje shume të rëndë të disiplinës në punë dhe me aktin nr. 5656/2 prot., datë 21.08.2019, ka njoftuar nëpunësen për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 26.08.2019, duke i bërë të ditur njëkohësisht garantimin e të drejtave që përcaktohen në pikën 7, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si e drejta për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, e drejta për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike, e drejta për t’u asistuar nga një avokat apo një përfaqësues ligjor, etj.

Nga ana tjetër, Komisioni Disiplinor, në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 21.08.2019, ka marrë në shqyrtim paraprak materialet e dosjes disiplinore në ngarkim të nëpunëses ***** dhe ka vendosur pezullimin nga ushtrimi i detyrës për këtë nëpunëse, deri në përfundim të procedimit administrativ disiplinor (*vendimmarrje e cila materializohet me vendimin e ndërmjetëm nr. 5656/4 prot., datë 21.08.2019*).

Seanca dëgjimore është zhvilluar rregullisht në datën 29.08.2019, për të cilën nëpunësja ***** ishte njoftuar që më parë, nëpërmjet aktit nr. 5656/6 prot., datë 23.08.2019 dhe për shkak të kompleksitetit të çështjes si dhe nevojës së anëtarëve të komisionit për tu njohur me materialet, seanca ka vazhduar në dt. 03.09.2019, për të cilën rezulton të jenë mbajtur procesverbalet përkatëse.

Në përfundim të sa sipër, Komisioni Disiplinor, me vendimin nr. 5656/9 prot., datë 03.09.2019, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, për nëpunësen *****. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se, 4 anëtarët e këtij komisioni kanë qenë dakord për dhënien e masës disiplinore ndaj nëpunëses subjekt procedimi disiplinor, ndërsa përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike, nuk ka qenë dakord për dhënien e kësaj mase disiplinore, duke votuar kundër.

Në vijim të vendimit të Komisionit Disiplinor, ka dalë akti administrativ nr. 5656/10 prot., datë 03.09.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare për këtë nëpunëse.

Duke mos qenë dakord me mënyrën e trajtimit dhe vlerësimit të kësaj çështje nga ana e grupit të riinspektimit dhe auditit të brendshëm të AKU-së dhe vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor, nëpunësja ***** me anë të një letre protokolluar me nr. 7117 prot., datë 18.09.2019, është ankuar pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (*e cila ka në vartësi institucionin e AKU-së*), nëpërmjet të cilës ka kërkuar konstatimin e paligjshmërisë së vendimit të marrë ndaj saj si dhe një rivlerësim të situatës nga një grup specialistësh të paanshëm.

Mbi bazën e ankesës së mësipërme, Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me urdhrin nr. 520, datë 19.09.2019, ka ngritur një grup pune i përbërë nga nëpunës të nivelit të mesën drejtues, i cili pasi shqyrtoi edhe një herë gjithë materialet dokumentare që kishte në dispozicion Komisioni Disiplinor, me aktin e protokolluar me nr. 7136/1 prot., datë 07.10.2019, kanë shprehur konkluzionin se inspektimi i kryer nga inspektorët ***** dhe ***** është kryer konform përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, në kundërshtim me sa është konkluduar në ri-inspektimin e kryer nga trupa e inspektorëve ***** dhe ***** , si dhe në raportin e Auditit të Brendshëm të AKU.

Në materialin përfundimtar, grupit të punës ka shprehur qëndrimin e tij, si për problemin nëse ishte e nevojshme paisja me licensë e subjektit, ashtu dhe për nevojën e ambalazhimit të produkteve të shitjes, duke sqaruar konkretisht :

- Në lidhje me mungesën e licencës, sqarohet se, pajisja me licensë është kërkesë ligjore për ato subjekte, për të cilat veprimtaria e tyre është prodhim e tregëtim i produkteve ushqimore me shumicë, jo për bizneset e vogla. Në referencë të dokumentacionit provues, konkretisht të xhiros vjetore të tre viteve të fundit (*dokument i administruar dhe gjatë procedimit disiplinor*), rezulton se subjekti GUAIACCHINO RAIA është biznes i vogël;

- Në lidhje me parregullsinë e pretenduar, për etiketimin e produkteve të prodhuara prej subjektit prodhues/tregëtar, nga grupi i punës së ministrisë është arritur në konkluzionin se, për aq kohë sa, kërkesat për etiketim për shitjen e produktit të paambalazhuar nuk janë të normuara, është e padrejtë që subjekti tregtar të penalizohet.

Grupi i punës i ngritur pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e ka dërguar raportin e tij pranë AKU-s, duke evidentuar qëndrimin e tij se në inspektimin e kryer prej nëpunësve ***** dhe ***** , nuk konstatohen shkelje të ligjit.

Nga shqyrtimi në tërësi i gjithë dokumentacionit që përmban praktika e dhënies së kësaj mase disiplinore, konstatohet se në këtë rast kemi të bëjmë me kuptim dhe zbatim të gabuar të legjislacionit material/procedural dhe të kriterëve që rregullojnë mënyrën e vlerësimit dhe klasifikimit të shkeljeve disiplinore.

Kjo pasqyrohet së pari, në përbërjen e Komisionit të Disiplinës, i cili nuk është ngritur sipas parimeve dhe kërkesave të përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil. Konkretisht, anëtari i Komisionit Sefer Sefa, i cili është i komanduar në pozicionin e Drejtorit të DRAKU Tiranë, me aktin nr. 2723, dt. 08.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU pa respektuar rregullin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, i cili kërkon kushtin e ruajtjes së kategorisë kur bëhet fjalë për një transferim të përkohshëm për interes të institucionit, është pjesëmarrës në këtë procedurë disiplinore, si anëtar i Komisionit Disiplinor në cilësinë e *“eprorit direkt”*.

Në kushtet kur akti i komandimit vjen në kundërshtim me kërkesat e ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, gjë që në kuptim të nenit 109 dhe 113, të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*, është akt i paligjshëm, arrihet në përfundimin se ky nëpunës nuk mund të marrë pjesë në përbërje të Komisionit Disiplinor me cilësinë e *“eprorit direkt”*, për shkak të mungesës së statusit për atë pozicion (*nga verifikimet e kryera, ky punonjës gëzon statusin e nëpunësit civil në nivelin ekzekutiv*). Ai, si personi i cili faktikisht drejton DRAKU-n Tiranë, mund të paraqitet para Komisionit e të relatojë çështjen, duke shtjelluar rrethanat dhe analizuar faktet, por nuk mund të ketë edhe të drejtën e votës në komision. Kjo shkelje procedurale, e vë nëpunësin e proceduar në kushtet e mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë, gjë e cila do të ketë ndikimin e vet edhe në ngjizjen e vendimit përfundimtar të komisionit dhe arritjen e konkluzioneve jo të drejta.

Nëse do të ishte respektuar procedura e përbërjes së Komisionit të Disiplinës, do të krijoheshin kushtet për të marrë një vendim më të balancuar, i cili mund të arrihej dhe vetëm pas ballafaqimit të paanshëm të mendimeve të ndryshme që kanë shprehur grupe të ndryshme inspektimi, për të njëjtën çështje.

Në këtë rast, në respektim të kërkesës së pikës 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, në përbërje të Komisionit Disiplinor duhej të ishte caktuar një drejtues në kategori analoge, i nje DRAKU, të një qarku tjetër. Vetem një përbërje e tillë e

Komisionit mund të siguronte arritjen e përfundimeve të sakta dhe dhënien e një vendimi të paanshëm.

Nga pikëpamja e themelit të çështjes, konstatohet se, Komisioni i Disiplinës ka arsyetuar në mënyrë sipërfaqësore, pa bërë analizën juridike të dispozitave të legjislacionit për ushqimin, duke marrë të mirëqëna konkluzionet e grupeve të riinspektimit se nëpunësja ***** nuk ka përmbushur detyrat funksionale të pozicionit të inspektorit dhe nuk ka zbatuar dispozitat ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale, pavarësisht se i ka pasur mundësitë objektive për evidentimin e shkeljeve ligjore të kryera nga ana e subjektit, në lidhje me mungesën e licencës për ushtrimin e veprimtarisë, etiketimin e parregullt të produkteve të tij, si dhe marrjen e masave përkatëse ndaj tij (*dhënien e një dënimi administrativ, sipas ligjit*).

Ky parashtrim i bërë në vendimin e komisionit, i cili i paraprin edhe konkluzionit përfundimtar të tij, nuk është rezultat i një analize të thellë e të paanshme të fakteve dhe pretendimeve të parashtruara nga palët. Në vendimin e Komisionit nuk gjen pasqyrim debati i zhvilluar gjatë shqyrtimit të çështjes dhe nuk bëhen përpjekje për të sqaruar përse nga ana e komisionit është mbajtur qëndrim në favor të një konkluzioni apo një tjetri, të paraqitura nga grupe të ndryshme inspektimi.

Konkretisht, përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike, i cili ka një rol të një rëndësie të veçantë në Komisionin Disiplinor, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga konkluzioni i komisionit dhe ka arsyetuar qëndrimin “kundër”, duke parashtruar mendimin e tij për mungesë të elementëve të shkeljes disiplinore, me argumentet si më poshtë:

- Nuk u provua përgjatë shqyrtimit të shkeljes së pretenduar se subjekti duhej të gjobitej nga inspektorët në procedim për mos pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit, pasi Udhëzimi nr. 32, datë 31.12.2013 “*Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël*” përcakton se, çdo biznes i cili realizon gjatë vitit një qarkullim më të vogël ose të barabartë me 8.000.000 (tetë milion lekë), i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Në kushtet kur ka rezultuar se subjekti ka kryer rregullisht pagesat e taksave vendore për 3 vitet e fundit, do të thotë se sipas VKM nr.538 datë 26.05.2019 “*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”. nuk ka patur detyrim të pajisej me licencë.
- Lidhur me pretendimin se inspektorja në procedim ka kryer shkelje pasi nuk e ka gjobitur subjektin për parregullsi në etiketim, nuk u provua përgjatë hetimit administrativ se si është procedura konkrete e etiketimit që duhet të bënte subjekti. E vetmja bazë ligjore që rregullon etiketimin e produkteve të brumit është VKM nr. 1344, datë 10.10.2008 “*Për miratimin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore*”, e cila thotë se, në rastin kur produkti ofrohet te konsumatori i fundit ose tek ushqimi social i paambalazhuar paraprakisht për shitje direkte, do të caktohet me një akt nënligjor. Por përgjatë hetimit

administrativ në Komisionin Disiplinor, nuk u paraqit ndonjë argument shtesë i provuar ligjërisht, apo ndonjë dispozitë ligjore ku të përcaktohet qartë procedura e etiketimit të produktit të paambalazhuar. Sa më sipër, nëpunësja në procedim nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për mosvënie gjobe në këto kushte.

Nga tërësia e dokumentacionit vënë në dispozicion për këtë rast konstatohet se, Komisioni i Disiplinës në kushtet kur nuk ka kryer verifikime apo hetim të mëtijshëm administrativ, ka marrë të mirëqëna ato fakte e arsyetime që janë ofruar prej eprorit direkt, duke arritur në një përfundim të padrejtë, kur ka vlerësuar se ndodhemi përpara një shkelje shumë të rëndë disiplinore e mbi këtë bazë ka aplikuar masën e largimit nga shërbimi civil.

Në debatin e zhvilluar në seancat e Komisionit të Disiplinës, nga ana e nëpunëseve të proceduara janë ngritur pretendime dhe argumente ligjore, të cilat duhej të ishin objekt i ballafaqimit të qëndrimeve të ndryshme dhe i thellimit në përmbajtjen e dispozitave të legjislacionit për ushqimin dhe të atij tatimor; vetëm pas sqarimit të shkaqeve të qëndrimeve të kundërta, të grupeve të ndryshme të inspektimit, do të mund të arrihej në përfundime të sakta e të drejta. Nëse do të kishte mbajtur një qëndrim të tillë dhe do të kishte bërë të gjitha përpjekjet për sqarimin e kontradiktave dhe qëndrimeve të ndryshme, prej organizmave të ndryshëm, Komisioni i Disiplinës do të arrinte të bënte një vlerësim më të drejtë të faktit nëse kemi të bëjmë me shkelje të disiplinës në rastin konkret, apo jemi ose jo, para një shkeljeje shumë të rëndë disiplinore, e cila të justifikonte dhënien e masës më të rëndë disiplinore, atë të largimit nga shërbimi civil.

Ky detyrim i Komisionit të Disiplinës parashikohet në pikën 14, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, e cila kërkon shprehimisht zgjerimin e hetimit administrativ për të bërë një vlerësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave të ngjarjes, duke përdorur të gjitha mjetet e nevojshme për mbledhjen e akteve dhe analizën e tyre, të cilat përbëjnë domosdoshmëri për një vendimmarrje të drejtë, të bazuar në prova dhe në ligj.

Gjithashtu, bazuar në pikën 4/c, të Kreut II, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, ankesa, kërkesa apo rekomandimi në lidhje me shkeljen disiplinore të pretenduar nga eprori direkt i nëpunësit për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen, nëpunësit e institucionit apo çdo organi tjetër publik, ose njësi me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi, duhet të plotësojë mes të tjerash dhe kushtin që konsiston në përcaktimin e veprimit konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij.

Në vijim, me përcaktimin e veprimit konkret që pretendohet si shkelje disiplinore eprori direkt ose komisioni disiplinor, duhet të përcaktojë masën disiplinore të zbatueshme sipas rastit, duke u bazuar në shkallën e fajësisë dhe shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes,

rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj, në përputhje me parimin për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore sipas përcaktimeve të nenit 60, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nëse në përfundim të kësaj analize, evidentohet mungesa e lidhjes shkakësore mes veprimeve apo mosveprimeve me pasojat e ardhura apo mungesa e elementit faj në këto veprime, Komisioni Disiplinor, në zbatim të nenit 17, germa “a” dhe “b”, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, duhet të kishte vendosur ndërprerjen e ecurisë disiplinore dhe pushimin e saj, duke arsyetuar se mospërbushja e detyrave funksionale në rastin e nëpunëses ***** nuk përmban elemente të fajit, si dhe elementë të tjerë të shkeljes disiplinore.

Nga analiza e gjithë sa u thanë më sipër dhe në referencë të dispozitave të mësipërme ligjore të përmendura rast pas rasti, konkludohet se, vendimmarrja e këtij komisioni nuk është rezultat i një hetimi të plotë e të paanshëm administrativ, por me shkeljet e kryera/lejuara gjatë këtij procesi administrativ, krijohet bindja se jemi para një vendimmarrjeje dhe një procesi të kryer me ngut, duke mos respektuar etapat e përcaktuara në legjislacionin e fushës.

Nisur nga sa është parashtruar më sipër, si dhe duke vlerësuar: a) raportin nr. 7136/1 prot., datë 07.10.2019, përgatitur prej grupit të punës të ngritur me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si instanca më e lartë e hierarkisë për garantimin e ligjshmërisë së procesit, në përmbajtje të së cilës nuk janë evidentuar shkelje në inspektimin e kryer nga inspektorët ***** dhe *****; b) qëndrimin kundër të përfaqësuesit të DAP, për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, arrihet në përfundimin se, vendimi nr. 5656/9 prot., datë 03.09.2019, i Komisionit Disiplinor, për lirimin nga shërbimi civil i nëpunëses *****, është akt i cili në kuptim të nenit 109, pika “b”, “d” dhe “dh” të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është akt administrativ i paligjshëm, e për këtë arsye, në referencë të nenit 113, pika 1, të po këtij ligji, ky akt duhet të anulohet, nga ana e Komisionit Disiplinor, i cili duhet të riorganizohet me përbërje të rregullt, ashtu siç është parashtruar në pjesën e mësipërme të këtij vendimi.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 113, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Drejtuesi i institucionit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, bazuar në nenin 113 pika 1, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, me qëllim rivendosijen e ligjshmërisë, të marrë masa për ngritjen e një Komisioni të ri Disiplinor, me përbërje sipas kërkesave të ligjit dhe orientimeve të përshkuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
2. Komisioni i ri Disiplinor, të anulojë vendimin nr. 5656/9 prot. dt. 03.09.2019 të Komisionit Disiplinor të mëparshëm, në respektim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Kreut I, pika 2, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, si dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”* dhe të kryejë rivlerësimin e rëndësisë së shkeljes, si dhe provave e fakteve që do të paraqiten gjatë procedimit disiplinor, duke bërë kujdes për sheshimin e kontradiktave që pasqyrohen në aktet e ndryshme të auditimeve të kryera në këtë rast.
3. Për kryerjen e veprimeve sa më sipër, lihet një afat 15 ditor, i cili fillon nga dita e njoftimit të këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohet për këtë Departamenti i Administratës Publike, Drejtori i Përgjithshëm i AKU, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, si dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha